



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.386/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kundërpërmbartimit sipas propozimit të kreditorit të kundërpërmbartimit Kompania e Sigurimeve “I...” SH.A., me seli në Prishtinë, me adresë Bulevardi “...” nr...., kundër debitorit të kundërpërmbartimit S...E... me seli në Prishtinë, Rr.“...” nr...., lidhur me çështjen e kundërpërmbartimit për kthimin e mjeteve, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të kundërpërmbartimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1138/2018 të datës 14.10.2020, me datë 06.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit të kundërpërmbartimit Kompania e Sigurimeve “I...” SH.A., me seli në Prishtinë, me adresë Bulevardi “...” nr...., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1138/2018 i datës 14.10.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1138/2018 të datës 14.10.2020, në pikën I të dispozitivit pjesërisht ka aprovuar propozimin e debitorit të kundërpërmbartimit, ka caktuar kundërpërmbartimin ndaj kreditorit të kundërpërmbartimit Kompania e Sigurimeve “I...” SH.A., me seli në Prishtinë, ka detyruar kreditorin e kundërpërmbartimit, që debitorit të kundërpërmbartimit S...E... me seli në Prishtinë, t’ia kthejë shumën prej 220.05 Euro, të cilat i janë marrë debitori në bazë të procedurës së përmbartimit të zbatuar pranë përmbartuesit privat Zyrës Përmbartimore Metaj Law me seli në Prishtinë, P.nr.372/2018 të datës 28.05.2018, sipas faturës F-68357/17 të datës 09.11.2017, me kamatë prej 8 % nga data 28.06.2018, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar propozim për kundërpërmbartim të debitorit S...E... me seli në Prishtinë, sa i përket shumës prej 220.05 Euro, sa i përket faturës F-44769/17 të datës 31.07.2017, i lejuar me këtë urdhër përmbartimor.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur kreditori i kundërpërmbartimit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës Përmbartimore dhe Kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me

propozim që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar, ashtu që propozimi për kundërpërbarim i debitorit të kundërpërbarimit të refuzohet, ndërsa urdhri përbarimor i lejuar nga përbaruesi privat Zyra Përbarimore Metaj Law, P.nr.372/2018 i datës 28.05.2018 të vërtetohet ose lënda të prishet dhe të kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, përmes gjyqtare individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania e Sigurimeve “I...” SH.A., me seli në Prishtinë, me adresë Bulevardi “...” nr.... ka paraqitur propozim për përbarim kundër debitorit të S...E... me seli në Prishtinë, Rr.“...” nr...., në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr. F-44769/17 të datës 31.07.2017 dhe faturës nr. F-68357/17 të datës 09.11.2017, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 440.10 Euro.

Përbaruesi privat, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.372/2018 të datës 28.05.2018, ka lejuar përbarimin, duke vlerësuar se faturat e lëshuar nga kreditori i plotësojnë kushtet për përbarim. Kundër këtij urdhri përbarimor debitori nuk ka paraqitur prapësim në afatin e paraparë ligjore, andaj përbaruesi privat me urdhrin P.nr.372/2018 të datës 25.06.2018, ka urdhëruar ... Bank me seli në Prishtinë, që nga llogaria e debitorit të bëhet transferimi i mjeteve në të holla, për borxhin ndaj kreditorit, në total shumën prej 657.54 Euro, dhe atë shumën prej 440.10 Euro për borxhin ndaj kreditorit dhe shumën prej 217.44 Euro për shpenzimet e procedurës përbarimore. Përbaruesi privat pas përmbushjes së kërkesës përbarimore të kreditorit ndaj debitorit për borxhin dhe shpenzimeve e tjera ka nxjerrë urdhrin përbarimor P.nr.372/2018 të datës 28.06.2018, me të cilin ka përfunduar procedurën përbarimore.

Debitori me datë 27.07.2018 pranë përbaruesit privat, ka paraqitur propozim për kundërpërbarim, kundër kreditorit Kompania e Sigurimeve “I...” SH.A., me seli në Prishtinë, me adresë Bulevardi “...” nr.33, të cilin propozim për kundërpërbarim debitori e ka precizuar në seancën e datës 14.10.2020, me kërkesë që të njëjti ti kthehet shuma prej 220.05 Euro me kamatë ligjore duke llogaritur nga dita e ushtrimit të propozim për kundërpërbarim si dhe shpenzimet procedurës, me arsyetimin se i njëjti faturën nr.F-68357/17 të datës 09.11.2017 e cila është përbaruar, e ka paguar me datë 07.12.2017. Ndërsa kreditori me datë 03.08.2018 ka paraqitur përgjigje në propozimin për kundërpërbarim, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të propozimit për kundërpërmbarrim të debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1138/18 të datës 14.10.2020, me të cilin ka aprovuar pjesërisht propozimin për kundërpërmbarrim të debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe pas mbajtës së seancës dëgjimore, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit pasi që ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për caktimin e kundërpërmbarrimit sipas nenit 54 paragrafi 1, pika 1 të LPP, pasi që në rastin konkret nga provat e deponuara nga debitori dhe nga deklarimi në seancë, vërtetohet se fatura F-68357/17 e datës 09.11.2017, është paguar nga debitori me datë 07.12.2017, çka shihet edhe nga llogaria e debitori në ... Bank në Prishtinë, mbi bazën e së cilës faturë është zbatuar përmbarrimi pranë përmbarruesit privat, ndërsa ka vendosur si në pikën II të dispozitivit pasi që urdhri përmbarrimor është caktuar në bazë të faturës me numër F-44769/17 të datës 31.07.2017, e cila edhe sipas deklarimit të debitorit rezulton e papaguar, andaj e njëjta faturë përbënë dokument përmbarrues dhe është përmbarruar. Tutje gjykata ka arsyetuar se nuk mund të bëjë precizimin e propozimit për përmbarrim të kreditorit ashtu siç pretendon i njëjti, meqenëse se fatura F-22920/17 e datës 20.04.2017 nuk figuron në shkresat e lëndës, pasi që urdhri përmbarrimor është caktuar në bazë të faturës nr. F-44769/17 të datës 31.07.2017 dhe faturës nr. F-68357/17 të datës 09.11.2017 kjo e fundit e paguar nga debitori me datë 07.12.2017.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, e përkrah Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të parashikuara me nenin 182 paragrafi 2 të LPK, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftueshme bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka aprovuar pjesërisht propozimin për kundërpërmbarrim të debitorit, pasi që në rastin konkret janë plotësuar kushtet për lejimin e kundërpërmbarrimit konform nenit 54 të LPP-së, i cili nen përcakton shkaqet për kundërpërmbarrim duke paraparë se: *“Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarrimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarrimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t’ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarrimit, në qoftë se: 1.1. dokumenti përmbarrues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik; 1.2. aktvendimi apo urdhri për përmbarrim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar; 1.3. gjatë kryerjes së*

procedurave përmbaruese, kreditori ka marrë më shumë sesa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përmbarimit dhe kamatat; 1.4. përmbarimi i kryer në një objekt specifik të përmbarimit është i palejuar”.

Nga shkresat e lëndës shihet se debitori propozimin për kundërpërmbarim e ka mbështetur në prova konkrete, e në bazë të së cilave vërtetohet se i njëjti faturën nr.F-68357/17 të datës 09.11.2017 e cila sipas propozimit të kreditorit është përmbaruar nga përmbaruesi privat, e ka paguar me datë 07.12.2017, kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë bankare të debitorit, ku rezulton se i njëjti ka bërë transfer bankare tek kreditori shumë prej 220.05 Euro, andaj në rastin konkret është sqaruar në masë të duhur se mbi cilën bazë debitorit duhet t'i kthehen mjetet monetare të përmbaruara nga përmbaruesi privat në bazë të propozimit për përmbarimit të kreditorit.

Duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.386/2022, me datë 06.09.2022

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti